



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 1343/Prot

Tiranë, më 05/05/2021

Lënda: Njoftim për shpallje të lëvizjes paralele

**SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE \_\_\_\_\_**

**DREJTORISË RAJONALE TË OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL  
PUBLIK \_\_\_\_\_**

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit të Kryeministrit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” i ndryshuar me Urdhërin nr. 107, datë 13.08.2020 dhe shkresës nr.129 prot, datë 27.04.2021 “Njoftim për shpalljen e lëvizjes paralele” të Drejtorisë Rajonale të Ofritit të Formimit Profesional Publik Shkodër, protokolluar në AKPA me nr.1343 prot, datë 30.04.2021,

-Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ju njofton shpalljen e procedurave të **lëvizjes paralele** për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik, në Drejtorinë Rajonale të Ofritit të Formimit Profesional Publik Shkodër, për pozicionin:

- 1 mësimdhënës të formimit teoriko-praktik me kohë të pjesshme në kursin “Gjuhë e huaj gjermane”

**1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik në Drejtorinë Rajonale të Ofritit të Formimit Profesional Publik Shkodër**

Aplikanti për mësimdhënës të formimit teorik-praktik, në Drejtorinë Rajonale të Ofritit të Formimit Profesional Publik Shkodër duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;

- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojnë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik në ofruesit e formimit profesional si vijon:

- a) të ketë minimalisht diplomë nga një shkollë e mesme profesionale/ pas të mesëm, kualifikim profesional mbi një vit në fushën/profesionin që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të formimit profesional;
- b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën është arsimuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

### **1. Vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentave**

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinal ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Dokumentacioni duhet të dorëzohet pranë Drejtorisë Rajonale të Ofritit të Formimit Profesional Publik Shkodër, brenda 5 ditëve nga njoftimi. Afati i njoftimit fillon më datë 06.05.2021.

-Nëse nuk paraqiten kërkesa për lëvizje paralele brenda afatit të mësipërm, në zbatim të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Drejtoria Rajonale e Ofritit e Formimit Profesional Publik Shkodër të fillojë procedurën për shpalljen e vendit të lirë, për pozicionin:

- 1 mësimdhënës të formimit teoriko-praktik me kohë të pjesshme në kursin “Gjuhë e huaj gjermane”

Drejtorja Rajonale e Ofritit e Formimit Profesional Publik Shkodër brenda 5 ditëve pune pasi është mbyllur procedura e lëvizjes paralele dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë për lëvizje paralele, shpall njoftimin për vendin e lirë në faqen zyrtare të AKPA-s, në faqen elektronike zyrtare të Drejtorisë Rajonale e Ofritit e Formimit Profesional Publik Shkodër, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Drejtorisë Rajonale të Ofritit të Formimit Profesional Publik Shkodër.

**DREJTORI PËRGJITHSHËM**

